

**VENDIM**  
**Nr. 63, datë 6.6.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE ME SERI PV11P, NR. 128, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 58, DATË 22.6.2011 PËR SHOQËRINË “DN & NAT ENERGJI”  
SHPK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 germat “a” dhe “b” të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.6.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “DN & NAT Energji” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr. 128, seria PV11P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 58, datë 22.6.2011 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “DN & NAT Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr. 128, seria PV11P, për prodhimin e energjisë elektrike të shoqërisë “DN & NAT s” sh.p.k., të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 58, datë 22.6.2011 nga hec “Kumbull Merkurth” me fuqi 630 kW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**